

LIGJ
Nr. 6/2023

**PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE
TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS SË
POLONISË PËR BASHKËPUNIMIN NË FUSHËN E MBROJTJES**

Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet marrëveshja ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës së Polonisë për bashkëpunimin në fushën e mbrojtjes sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij ligji.

Neni 2

Shfuqizohet ligji nr. 9139, datë 16.10.2003, “Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet qeverisë së Republikës të Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës së Polonisë për bashkëpunim në fushën e mbrojtjes”.

Neni 3

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren zyrtare.

Miraturar më datë 2.2.2023.

**Shpallur me dekretin nr. 25, datë 15.2.2023, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Bajram Begaj**

MARRËVESHJE
NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE
QEVERISË SË REPUBLIKËS SË POLONISË PËR BASHKËPUNIMIN NË FUSHËN E
MBROJTJES

Qeveria e Republikës së Polonisë dhe Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë, më poshtë referuar “Palët”,

Duke pasur parasysh dispozitat e Traktatit Atlantik Verior, të përfunduar në Uashington, më 4 prill 1949,

Duke pasur parasysh dispozitat e Marrëveshjes ndërmjet Palëve në Traktatin Atlantik Verior në lidhje me statusin e forcave të tyre, të përfunduar në Londër më 19 qershor 1951 (NATO SOFA),

Me dëshirën për të zhvilluar dhe forcuar bashkëpunimin ndërmjet Palëve si një kontribut për paqen dhe sigurinë ndërkombëtare,

Kanë rënë dakord si më poshtë:

Neni 1
Qëllimi

Qëllimi i kësaj Marrëveshjeje është vendosja e kuadrit ligjor dhe dispozitave të përgjithshme në lidhje me bashkëpunimin ndërmjet Palëve në çështjet e mbrojtjes.

Neni 2 **Përkufizime**

Për qëllimet e kësaj Marrëveshjeje, termi:

- a) “personel ushtarak” do të thotë anëtarët e Forcave të Armatosura të Palëve;
- b) “personel civil” do të thotë të punësuarit civilë të Forcave të Armatosura të Palëve;
- c) “Pala Dërguese” do të thotë një Palë që dërgon personelin e saj civil dhe ushtarak në territorin shtetëror të Palës tjetër në pajtim me dispozitat e kësaj Marrëveshjeje;
- d) “Pala Pritëse” do të thotë Pala që pret personelin civil dhe ushtarak të Palës Dërguese në pajtim me dispozitat e kësaj Marrëveshjeje.

Neni 3 **Fusha e bashkëpunimit**

1. Bashkëpunimi ndërmjet Palëve kryhet në fushat e mëposhtme:

- a) misionet dhe operacionet ndërkombëtare, duke përfshirë operacionet paqe-ruajtëse, aktivitetet e kërkim-shpëtimit dhe operacionet humanitare, si dhe iniciativat e përbashkëta në kuadrin e angazhimeve të organizatave ndërkombëtare, në të cilat janë anëtare të dyja Palët;
- b) stërvitjet e përbashkëta ushtarake;
- c) edukimin dhe trajnimin e personelit civil dhe ushtarak të forcave të armatosura të Palëve;
- d) industrinë e mbrojtjes, shkencën dhe teknologjinë për modernizimin e forcave të armatosura të Palëve;
- e) mbështetjen teknike dhe logjistike për forcat e armatosura të Palëve dhe konsulencën në këtë fushë;
- f) çështjet në lidhje me sigurinë e informacionit të klasifikuar në pajtim me ligjin e zbatueshëm të brendshëm të palëve dhe atë ndërkombëtar;
- g) shkëmbimin e informacionit në lidhje me mbikëqyrjen e hapësirës ajrore, konsulencën, trajnimet e përbashkëta dhe stërvitjet në këtë fushë;
- h) mjekësinë ushtarake;
- i) çështjet ligjore në fushën e mbrojtjes;
- j) arkivat dhe muzeumet ushtarake;
- k) aktivitetet kulturore dhe sportive.

2. Me qëllim që të zbatohet bashkëpunimi në fushat e përmendura në paragrafin 1, të këtij neni, Palët mund të vendosin masa specifike zbatuese.

Neni 4 **Format e bashkëpunimit**

Bashkëpunimi ndërmjet Palëve realizohet, veçanërisht, në format e mëposhtme:

- a) vizitat e punës dhe kontaktet ndërmjet nëpunësve të Palëve;
- b) vizitat e delegacioneve ushtarake dhe civile;
- c) pjesëmarrja në ekspozimin e pajisjeve dhe armëve luftarake, stërvitjet ushtarake, seminarët dhe konferencat;
- d) shkëmbimi i trajnimit për personelin civil dhe ushtarak.

Neni 5 **Mbikëqyrja e zbatimit të Marrëveshjes**

Autoritetet përgjegjëse për zbatimin e kësaj Marrëveshjeje janë: ministri i Mbrojtjes Kombëtare dhe ministri kompetent për çështjet e ekonomisë në emër të Qeverisë së Republikës së Polonisë dhe ministri i Mbrojtjes në emër të Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë.

Neni 6

Planet vjetore të bashkëpunimit

1. Zbatimi i bashkëpunimit bazohet në aktivitete të rëna dakord bashkërisht. Palët mund të bëjnë propozime konkrete, që shkëmbehen nëpërmjet kanaleve të përshtatshme.

2. Bazuar në propozimet e përmendura në par 1, Palët zhvillojnë një plan vjetor bashkëpunimi i cili nënshkruhet nga përfaqësuesit e autorizuar të Palëve.

3. Plan i bashkëpunimit vjetor përmban informacion në lidhje me titullin e aktivitetit, kohën dhe vendin e realizimit dhe numrin e pjesëmarrësve. Nëse është e nevojshme përfshihet informacion i mëtejshëm.

Neni 7

Aspekte financiare

1. Për qëllimet e bashkëpunimit, në bazë të reciprocitetit, secila Palë mbulon shpenzimet e saj në lidhje me aktivitetet e zhvilluara sipas dispozitave të kësaj Marrëveshjeje, përveç kur bihet dakord ndryshe nga Palët.

2. Pala Dërguese mbulon shpenzimet e mëposhtme:

- a) udhëtimit për në dhe nga territori i shtetit të Palës pritëse;
- b) akomodimit dhe ushqimit;
- c) sigurimeve për anëtarët e delegacionit, duke përfshirë sigurimet mjekësore jo-emergjente;
- d) lëshimin e dokumenteve të hyrjes dhe largimit, siç kërkohet nga Pala Pritëse.

3. Pala Pritëse mbulon shpenzimet e mëposhtme:

- a) transportin e brendshëm për delegatët e Palës Dërguese pas hyrjes së tyre në territorin e shtetit të Palës Dërguese;
- b) kujdesin mjekësor emergjent;
- c) programeve kulturore me kërkesë.

Neni 8

Statusi i personelit civil dhe ushtarak

Gjatë qëndrimit në territorin e shtetit të Palës Pritëse, statusi i personelit ushtarak dhe civil të Shtetit Dërgues rregullohet nga dispozitat e Marrëveshjes ndërmjet Palëve të Traktatit Atlantik Verior në lidhje me statusin e forcave të tyre, të përfunduar në Londër, më 19 qershor 1951 (NATO SOFA).

Neni 9

Mbrojtja e Informacionit të Klasifikuar

I gjithë informacioni i klasifikuar, i shkëmbyer ose gjeneruar në lidhje me këtë Marrëveshje përdoret, transmetohet, ruhet, trajtohet dhe/ose mbrohet në pajtim me Marrëveshjen ndërmjet Qeverisë së Republikës së Polonisë dhe Qeverisë së Republikës së Shqipërisë për Mbrojtjen e Ndërsjellë të Informacionit të Klasifikuar, të lidhur në Tiranë më 21 shtator 2004.

Neni 10

Mbrojtja e të dhënave personale

1. Pala që merr të dhënat personale brenda bashkëpunimit të ndërmarrë sipas kësaj Marrëveshjeje i përdor këto të dhëna vetëm për të ekzekutuar këtë Marrëveshje dhe sipas kushteve të caktuara nga Pala tjetër që jep të dhënat.

2. Pala që merr të dhënat personale nuk i ruan ato më gjatë se është e nevojshme për të arritur qëllimet e të përpunimit të të dhënave dhe sapo të pushojë së ekzistuari qëllimi, Pala që merr të dhënat, i fshin të dhënat e ruajtura pa vonesë dhe njofton Palën tjetër që i ka dërguar këto të dhëna.

3. Palët regjistrojnë transferimin, marrjen, përdorimin dhe fshirjen e të dhënave personale të transferuara sipas kësaj Marrëveshjeje.

4. Palët konfirmojnë saktësinë e të dhënave të transferuara. Nëse pala transferon të dhëna të pasaktë ose të dhëna të patransferueshme, ajo njofton pa vonesë Palën tjetër. Pala që merr këto të dhëna i korrigjon ose i fshin ato.

5. Palët ofrojnë nivelin e nevojshëm për mbrojtjen e të dhënave personale të marra nga përpunimi i paautorizuar ose i paligjshëm dhe humbja aksidentale, dëmtimi ose korrupsioni.

6. Palët njoftojnë njëra-tjetrën në lidhje me shkeljet e të drejtave të mbrojtjes së të dhënave personale të marra sipas kësaj Marrëveshjeje, nëse kjo shkelje mund të shkaktojë risk të lartë të shkeljes së të drejtave dhe lirive të personave, të dhënat e të cilëve janë marrë.

7. Palët marrin përsipër të gjitha veprimet e mundshme me qëllim që të shmangin pasojat e referuara në pikën 6 dhe për të siguruar ushtrimin e të drejtave të personave, të dhënat e të cilëve merren.

Neni 11

Dispozita të fundit

1. Kjo Marrëveshje i nënshtrohet pranimi nga Palët në pajtim me legjislacionin e tyre të brendshëm për të cilën Palët njoftojnë njëra-tjetrën. Marrëveshja hyn në fuqi 30 ditë pas datës së marrjes së njoftimit të fundit.

2. Kjo Marrëveshje mund të ndryshohet me pëlqimin me shkrim të Palëve.

3. Kjo Marrëveshje lidhet për një afat të pacaktuar kohor. Secila Palë mund ta prishë këtë Marrëveshje nëpërmjet njoftimit dhe në një rast të tillë Marrëveshjes i pushon fuqia 6 muaj pas datës së një njoftimit të tillë.

4. Çdo mosmarrëveshje në lidhje me interpretimin ose zbatimin e kësaj Marrëveshjeje zgjidhet ekskluzivisht ndërmjet Palëve me masa diplomatike.

5. Në datën e hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje, Marrëveshja ndërmjet Qeverisë së Republikës së Polonisë dhe Qeverisë së Republikës së Shqipërisë në lidhje me bashkëpunimin në fushën e mbrojtjes, e lidhur në Varshavë, më 18 korrik 2003, shfuqizohet.

Nënshkruar në Bruksel, më 16.6.2022, në dy kopje origjinale, secila në gjuhët polake, shqipe dhe angleze, ku të gjitha tekstet janë njëloj autentike. Në rastin e mospërputhjes në interpretim, mbizotëron teksti në anglisht.

Për Këshillin e Ministrave të Republikës së Shqipërisë

Niko Peleshi

Për Qeverinë e Republikës së Polonisë

Mariusz Błaszczak